

**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**MATERIAL MËSIMOR MBËSHTETËS**

**PËR**

**REALIZIMIN E PROGRAMIT TË MODULIT PROFESIONAL**

**“PUNIME TË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES  
MEKANIKE”**

**Për kurrikulën me zgjedhje të lirë në gjimnaz**

**Tiranë, 2012**

**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**UDHËZUES PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË MODULIT  
PROFESIONAL**

**“PUNIME TË RIPARIMIT DHE TË MIRËMBAJTJES  
MEKANIKE”**

**Përgatiti:**

Alqi Mustafai

**Redaktimi shkencor:**

Dr. Mirela Andoni

**Redaktore letrare:**

Freskida Miloti

## **PËRMBAJTJA**

<b>1. HYRJE</b>	<b>4</b>
1.1. Cili është qëllimi i “Udhëzuesit”?	4
1.2. Çfarë përmban “Udhëzuesi”?	4
1.3. Si duhet përdorur “Udhëzuesi mësimor”?	5
<b>2. INFORMACION PLOTËSUES PËR MODULIN</b>	<b>6</b>
2.1. Të dhëna të përgjithshme për Modulin	6
2.2. Qëllimi i përgjithshëm i Modulit	7
2.3. Rezultatet mësimore të Modulit	8
2.4. Udhëzime të përgjithshme për zbatimin e Modulit	9
<b>3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E REZULTATEVE MËSIMORE</b>	<b>10</b>
3.1. Materiale plotësuese për përmbajtjen e rezultateve mësimore	10
3.2. Udhëzime për metodologjinë dhe kushtet e zbatimit të Modulit	11

## 1. HYRJE

### 1.1. Cili është qëllimi i “Udhëzuesit”?

“Udhëzuesi” për zbatimin e modulit “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” ka për qëllim të ndihmojë mësuesit që do ta trajtojnë këtë modul, si dhe nxënësit që do ta përzgjedhin atë, për të bërë një organizim sa më të mirë të procesit mësimor dhe për të përmbushur në shkallën e duhur objektivat mësimore të parashikuara.

Ky “Udhëzues” përmban informacione që i ndihmojnë mësuesit për zbërthimin e objektivave mësimore të modulit, për plotësimin e njohurive dhe të përmbajtjeve mësimore të tij, për përzgjedhjen, planifikimin dhe organizimin e veprimtarive mësimore të përshtatshme, si dhe për vlerësimin e duhur të arritjeve të nxënësve gjatë zbatimit të modulit.

“Udhëzuesi” u jep mësuesve edhe hapësirën e nevojshme për ta rishikuar, plotësuar, përshtatur dhe përdorur materialin teorik dhe praktik, sipas kushteve konkrete në të cilat do të zbatohet moduli.

### 1.2. Çfarë përmban “Udhëzuesi”?

“Udhëzuesi” për zbatimin e modulit “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” përmban informacion plotësues të fokusuar kryesisht në:

- zbërthimin e objektivave (RM-ve) të modulit;
- plotësimin e përmbajtjeve mësimore të modulit, që kanë të bëjnë me njohuritë teorike dhe shprehitë praktike të përfshira në modul;
- pajisjen e mësuesve (dhe të nxënësve) me materiale mbështetëse për trajtimin e aspekteve teorike dhe praktike të RM-ve të modulit;
- udhëzimin e mësuesve në lidhje me aspektet metodike të trajtimit të modulit;
- udhëzimin e mësuesve në lidhje me aspektet e vlerësimit të nxënësve për shkallën e përmbushjes së RM-ve të modulit;
- udhëzimin e mësuesve në lidhje me aspektet organizative dhe të kushteve të zbatimit të modulit.

“Udhëzuesi” për zbatimin e modulit “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” përmban gjithashtu edhe informacione të tjera plotësuese që ndihmojnë mësuesit dhe nxënësit në zbatimin e tij.

### **1.3. Si duhet përdorur “Udhëzuesi” mësimeor?**

“Udhëzuesi” për zbatimin e modulit “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” duhet të përdoret nga mësuesit që do ta trajtojnë këtë modul si një material plotësues dhe orientues i *përshkruesit të modulit* përkatës (i cili është dokumenti bazë dhe i detyrueshëm për zbatimin tij).

Mësuesit që do të përdorin këtë “Udhëzues” do të kenë mundësi të mbështeten te:

- a) udhëzimet e përgjithshme, të cilat kanë të bëjnë me të gjitha RM-të e modulit;
- b) udhëzimet e veçanta, të cilat kanë të bëjnë me RM-të e veçanta;
- c) materialet plotësuese dhe orientuese në lidhje me përmbajtjen e RM-ve.

Mësuesit mund të përdorin materiale dhe ilustrime të këtij “Udhëzuesi” për t’i prezantuar në klasë ose për t’i shumëfishuar dhe për t’jua shpërndarë nxënësve si materiale burimore.

Udhëzimet, rekomandimet dhe shembujt që jepen në këtë “Udhëzues” nuk janë detyruese dhe janë vetë mësuesit që mund t’i ndryshojnë dhe përshtatin ato në përputhje me kushtet dhe mundësitë konkrete të zbatimit të modulit “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike”.

Mësuesit janë të lirë për ta pasuruar këtë “Udhëzues” me materiale të tjera përmbajtjesore që janë në përputhje me RM-të e modulit, materiale të cilat mund t’i gjejnë nga burime të ndryshme.

## 2. INFORMACION PLOTËSUES PËR MODULIN

### 2.1. Të dhëna të përgjithshme për Modulin

Moduli “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” është pjesë e një cikli modulesh me zgjedhje për të gjitha klasat e gjimnazit. Ai do të trajtohet me ata nxënës të klasave të ndryshme të gjimnazit (10,11 ose 12), të cilët do të vendosin të zgjedhin këtë modul në kuadrin e moduleve me zgjedhje të lirë.

*Kohëzgjatja minimale* e Modulit është 36 orë mësimore (1 Kredit) ndërsa *kohëzgjatja maksimale* e tij është e papërcaktuar dhe kjo është zgjedhje e shkollës që do të trajtojë modulin.

Përshkruesi i Modulit “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” ka strukturë modulare, me fokusim te Rezultatet Mësimore (RM), të cilat priten të përmbushen nga vetë nxënësit në fund të veprimtarive mësimore të orientuara nga praktikimi i tyre për ato aspekte që përmban moduli.

*Elementet bazë strukturorë* të përshkruesit të modulit janë:

- Titulli i modulit, i cili tregon fushën ku janë fokusuar veprimtaritë e nxënësve gjatë trajtimit të modulit.
- Qëllimi i modulit, shpreh kompetencën themelore që do të zhvillohet te nxënësit me përfundimin e suksesshëm të veprimtarive të modulit.
- Kohëzgjatja minimale e modulit tregon se në sa orë mësimore do të trajtohen veprimtaritë mësimore të RM 1 (teorik) dhe të njërit nga RM-të praktike.
- Niveli i parapëlqyer për pranim, tregon se çfarë kërkesash duhet të plotësojë nxënësi për t’u përfshirë në trajtimin e modulit.
- Rezultati Mësimor (RM) tregon arritjet (teorike dhe praktike) e pritshme të nxënësit në përfundim të veprimtarive mësimore të planifikuara për këtë RM.
- Përmbajtja (e RM-së përkatëse) përshkruan aspektet teorike (njohuritë) dhe praktike (procedurat e punës) të cilat rekomandohet

të trajtohen gjatë zbatimit për të mundësuar arritjen e kësaj RM-je nga nxënësit.

- Instrumenti i vlerësimit, tregon mënyrën se si do të verifikohet shkalla e përmbushjes së RM-së nga nxënësit.
- Kriteret e vlerësimit, shërbejnë si “standarde” që mundësojnë krahasimin e arritjeve reale të nxënësve, me ato që pritet të arrihen.
- Udhëzime për zbatimin e modulit, përmbajnë disa rekomandime të përgjithshme për organizimin dhe zbatimin e modulit, si dhe për vlerësimin e nxënësve.
- Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit, përmbajnë listën e mjediseve, veglave, pajisjeve dhe materialeve, pa të cilat do të ishte e vështirë përmbushja e duhur e RM-ve të modulit.

Nga rubrikat e mësipërme, një pjesë janë detyruese (qëllimi, kohëzgjatja minimale, RM-të dhe kriteret e vlerësimit), ndërsa të tjerat janë rekomanduese dhe mund të përshtaten me kushtet reale të zbatimit të modulit.

## **2.2. Qëllimi i përgjithshëm i Modulit**

Moduli “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” i referohet njohurive që nxënësit kanë fituar në lëndë të tjera, të cilat do të gjejnë zbatim në veprimtaritë praktike të mirëmbajtjes dhe riparimit të objekteve të ndryshme mekanike.

*Nëpërmjet veprimtarive teorike dhe praktike të parashikuara në modul synohet zhvillimi i aftësive psikomotore të nxënësve për të analizuar objekte e pajisje mekanike dhe skicat e vizatimet e tyre, për të përzgjedhur materiale të ndryshme, për të përdorur vegla dhe pajisje të thjeshta, për të kryer punime të thjeshta të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike, për të zbatuar rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, për të komunikuar dhe bashkëpunuar në grupe të vogla etj.*

Ky modul teorik dhe praktik i ndihmon nxënësit që të vendosin një marrëdhënie konkrete dhe të drejtpërdrejtë me veprimtaritë praktike, një pjesë e të cilave mund të jenë edhe me karakter profesional, si dhe

të krijojnë një “ndjesi” edhe për natyrën e profesioneve të cilat i “prek” ky modul (mekanik, automekanik, axhustator). Përfshirja në veprimtari të tilla i ndihmon nxënësit për një *orientim më të mirë për karrierën e tyre të ardhshme*, si për atë që ka të bëjë me shkollimin dhe trajnimin e mëtejshëm, ashtu dhe për punësimin e mundshëm në të ardhmen.

Moduli “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” nuk ka si qëllim në vetvete zhvillimin e kompetencave profesionale të nxënësve, por shërben edhe si mjet për zhvillimin e njohurive dhe aftësive kyçe jetësore dhe ndërprofesionale. Transferimi në kontekste të tjera, profesionale dhe joprofesionale, i njohurive dhe aftësive të fituara në kuadrin e këtij moduli, është një mundësi që i jepet individëve në kuadrin e *të nxënit gjatë gjithë jetës*.

### 2.3. Rezultatet Mësimore të Modullit

Moduli “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike” përmban këto *Rezultate Mësimore (RM)*:

**RM1** (paraparak – i detyruar): Nxënësi përshkruan punimet e thjeshta të mirëmbajtjes mekanike.

**RM2** (me zgjedhje): Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të biçikletës.

**RM3** (me zgjedhje): Nxënësi kryen zëvendësime të pjesëve të bravave të dyerve.

**RM4** (me zgjedhje): Nxënësi kryen mirëmbajtje të thjeshta në automjetet e lehta.

**RM5** (me zgjedhje): Nxënësi kryen punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit në pajisje të ndryshme mekanike me përdorim shtëpiak.

Këto 5 Rezultate Mësimore kanë të bëjnë me aspektet teorike dhe me veprimtaritë praktike të mirëmbajtjeve dhe të riparimeve të thjeshta që zakonisht kryhen në objektet dhe pajisjet mekanike, kryesisht me përdorim shtëpiak.



## 2.4. Udhëzime të përgjithshme për zbatimin e Modulit:

Për zbatimin e Modulit “Punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike”, mësuesit duhet të mbajnë parasysht që:

- çdo RM ka një kohëzgjatje prej 18 orësh mësimore;
- nxënësit duhet të përmbushin jo më pak se dy RM, ku RM1 është rezultat mësimor paraprak (hyrës), me orientim teorik, i detyrueshëm të përmbushet nga të gjithë nxënësit përpara përmbushjes së RM-ve të tjera;
- rezultatet mësimore nga RM2 deri te RM5 janë me orientim praktik;
- nxënësit duhet të zgjedhin për të kryer të paktën njërin nga katër RM-të praktike, kjo sipas interesave dhe dëshirave të tyre, si dhe sipas mundësive të shkollës për t’i ofruar;
- një nxënës fiton të paktën 1 Kredit kur përmbush RM1 + një nga RM-të praktike (pra  $18 + 18 = 36$  orë mësimore). për çdo RM tjetër praktik që përmbush, nxënësit i shtohen 0,5 kredi (18 orë mësimore);
- pas përmbushjes së RM1 teorik, gjatë përmbushjes së RM-ve praktike, në varësi të kushteve dhe mjediseve që ofron shkolla, nxënësit mund të ndahen në dy ose më shumë grupe që angazhohen në përmbushjen e dy ose më shumë RM-ve paralelisht.

### 3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E REZULTATEVE MËSIMORE

#### 3.1. Materiale plotësuese për përmbajtjen e rezultateve mësimore

***Në lidhje me RM1: Nxënësi përshkruan punimet e thjeshta të mirëmbajtjes mekanike.***

Rezultati Mësimor Nr. 1 është me karakter teorik (njohës dhe përshkruar) dhe synon përgatitjen paraprake të nxënësve përpara se ata të fillojnë veprimtaritë praktike të parashikuara në RM-të pasardhëse.

Në këtë RM përfshihen këto përmbajtje kryesore dhe plotësuese:

- Makinat dhe pajisjet mekanike kryesore me përdorim shtëpiak janë:
  - autoveturat, veçoritë konstruktive;
  - biçikletat, veçoritë konstruktive;
  - bravat e dyerve, veçoritë konstruktive;
  - karrocet e fëmijëve veçoritë konstruktive;
  - krevatet portative, veçoritë konstruktive;
  - menteshat e ndryshme, veçoritë konstruktive;
  - tavolinat metalike, veçoritë konstruktive;
  - karriget metalike, veçoritë konstruktive.
  
- Veglat dhe pajisjet

kryesore që përdoren për punime të thjeshta mekanike janë:

- çekiçët, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - pincat, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - darët, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - kaçavidat, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - çelësat, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - hegzagonët, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - sharrat metalike, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - pajisjet shpuese (trapanot) elektrike, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - daltat, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - limat, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - letrat zmerile, llojet dhe përdorimi i tyre;
  - morsetat shtrënguese, llojet dhe përdorimi i tyre.
- Katalogët dhe manualët e makinave dhe pajisjeve mekanike me përdorim shtëpiak përmbajnë:
    - shenjat konvencionale që përdoren për paraqitjen skematike të objekteve mekanike;
    - interpretimin e skemave të objekteve mekanike.
  - Parregullsitë dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen te biçikletat janë:
    - lirimi i vidave dhe bulonave që shërbejnë për montimin e pjesëve të ndryshme të biçikletës (feneri, zilja, mbulesa e zinxhirit, dorezat e frenave, shala etj.), shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
    - procedura e shtrëngimit të lidhjeve të liruara;
    - lirimi i aksit të rrotës së përparme të biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
    - procedura e shtrëngimit dhe regjistrimit të aksit të rrotës së përparme të biçikletës;
    - lirimi i aksit të rrotës së prapme të biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
    - procedura e shtrëngimit dhe regjistrimit të aksit të rrotës së prapme të biçikletës;
    - lirimi i aksit të mesit (të pedaleve) të biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;

- procedura e shtrëngimit dhe regjistrimit të aksit të mesit të biçikletës;
- lirimi i aksit të pedalit të biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
- procedura e shtrëngimit aksit të pedalit të biçikletës;
- lirimi i pjesëve të pedalit të biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
- procedura e shtrëngimit dhe regjistrimit të pedalit të biçikletës;
- lirimi dhe dalja e zinxhirit të biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
- procedura e vendosjes dhe regjistrimit të zinxhirit të biçikletës;
- konsumimi i gominave të frenave të biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;



### **Kontrolli i biçikletës**

- procedura e zëvendësimit të gominave të frenave të biçikletës;
- këputja e kabullit të frenave të biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
- procedura e zëvendësimit të kabullit të frenave të biçikletës;
- procedura e regjistrimit të frenave të biçikletës;
- shtrembërimi i diskut të rrotës së biçikletës, shkaqet, pasojat,

- treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
  - procedura e drejtimit të diskut të rrotës së biçikletës;
  - këputja e telave të rrotës së biçikletës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
  - procedura e zëvendësimit të telave të rrotës së biçikletës;
  - shpimi i gomës së rrotës së biçikletës;
  - procedura e çmontimit të kopertonit dhe kamerdares, ngjitjes së kamerdares, montimit të tyre dhe fryrjes së gomës;
  - vajisjet dhe grasatimet në pjesët e lëvizshme të biçikletës, rëndësia e tyre;
  - procedura e vajisjes dhe grasatimit në pjesët e lëvizshme të biçikletës.
- Defektet dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen te bravat e dyerve janë:
    - bllokimi i gjuhëzës së bravës së derës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
    - procedura e zhbllokimit të gjuhëzës së bravës së derës;
    - bllokimi i fishekut të bravës së derës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
    - procedura e zhbllokimit ose zëvendësimit të fishekut të bravës së derës;
    - lirimi i dorezës së bravës së derës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
    - procedura e shtrëngimit të dorezës së bravës së derës;
    - bllokimi i gjuhëzës së dorezës së derës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
    - procedura e zhbllokimit të gjuhëzës së dorezës së derës;
    - lirimi i kapakëve të bravës së derës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
    - procedura e shtrëngimit të kapakëve të bravës së derës;
    - vajisja e pjesëve të lëvizshme të bravës së derës, rëndësia e saj;
    - procedura e vajisjes në pjesët e lëvizshme të bravës së derës.
  - Parregullsitë dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen në automjetet e lehta janë:
    - rënia e nivelit të vajit të motorit, shkaqet, pasojat, treguesit që

ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;

- procedura plotësimit me vaj të motorit;



### **Kontrolli i autoveturës**

- rënia e nivelit të ujit në rezervuarin e sistemit të ftohjes së motorit, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
  - procedura plotësimit me ujë të rezervuarit të sistemit të ftohjes së motorit;
  - mosfunksionimi si duhet i fshirësit të xhamit të autoveturës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
  - procedura e zëvendësimit të fshirësit të xhamit të autoveturës;
  - bllokimi ose mbushja me papastërti e filtrit të ajrit të motorit të autoveturës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
  - procedura e zëvendësimit të filtrit të ajrit të motorit të autoveturës;
  - defektet kryesore të rrota të autoveturës, shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e parregullsisë;
  - procedura e zëvendësimit të rrotës së dëmtuar, me rrotën rezervë të autoveturës.
- Defektet dhe punimet e thjeshta mekanike që kryhen në pajisje të tjera mekanike me përdorim shtëpiak (karrocet e fëmijëve, krevatet portative, menteshat e kapakëve të raftëve, tavolinat dhe karriget

metalike etj.) janë:

- parregullsitë e karrocave të fëmijëve (shfiletimet, lirimet, këputjet, shtrembërimet), shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e tyre;
  - procedura e riparimit ose zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara te karrocet e fëmijëve;
  - parregullsitë kryesore te krevatet portative (shfiletimet, lirimet, këputjet, shtrembërimet), shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e tyre;
  - procedura e riparimit ose zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara te krevatet portative;
  - parregullsitë kryesore te menteshat e kapakëve të rafteve (shfiletimet, lirimet, çregjistrimet), shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e tyre;
  - procedura e shtrëngimit, regjistrimit ose zëvendësimit të menteshave të kapakëve të rafteve;
  - parregullsitë kryesore te karriget dhe tavolinat metalike (shfiletimet, lirimet, këputjet, shtrembërimet), shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e tyre;
  - procedura e riparimit ose zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara te karriget dhe tavolinat metalike;
  - parregullsitë kryesore te objekte dhe pajisje të tjera metalike me përdorim shtëpiak (shfiletimet, lirimet, këputjet, shtrembërimet), shkaqet, pasojat, treguesit që ndihmojnë në përcaktimin e tyre;
  - procedura e riparimit ose zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara të objekteve dhe pajisjeve të tjera metalike me përdorim shtëpiak.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës janë:
    - rregullat dhe veprimet për mirëmbajtjen e veglave, instrumenteve dhe pajisjeve për punimet e riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike;
    - pastrimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës, pas kryerjes së punimeve mekanike;
    - sistemimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
    - pastrimi i vendit të punës pas kryerjes së punimeve mekanike;
    - kujdesi për sistemimin e materialeve të punës për punime mekanike.



- Rregullat bazë të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit dhe mirëmbajtjes mekanike janë:
  - veprimet për mbrojtjen nga goditja e rrymës elektrike gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike;
  - veprimet për mbrojtjen nga dëmtimet fizike (prerjet, thyerjet, goditjet, traumat, dëmtimet e syve etj.) gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike;
  - veprimet për sigurimin e jetës gjatë punimeve në lartësi;
  - veprimet për mos-dëmtimin e mjedisit, mjeteve dhe materialeve të punës gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike;
  - veprimet për mbrojtjen e mjedisit rrethues gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike;
  - veprimet për dhënien e ndihmës së parë për personat e dëmtuar gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike.

**Në lidhje me RM2: Nxënësi kryen mirëmbajtje dhe riparime të biçikletës.**

Rezultati Mësimor Nr.2 është me karakter praktik dhe synon aftësimin e nxënësve për të kryer mirëmbajtje dhe riparime të thjeshta në biçikleta të llojeve të ndryshme, me përdorimin e veglave, instrumenteve dhe materialeve përkatëse. Zbatimi i rregullave të sigurisë duhet të jetë përparësi gjatë realizimit të kësaj RM-je.

Në këtë RM përfshihen këto përmbajtje kryesore dhe plotësuese:

- Përcaktimi i parregullsisve mekanike



**Biçikleta**



të biçikletës është:

- kontrolli me sy për përcaktimin e parregullsive mekanike të biçikletës;
- kontrolli në ecje për përcaktimin e parregullsive mekanike të biçikletës;
- kontrolli i funksionimit të pjesëve të veçanta të biçikletës.


Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve të punës për mirëmbajtjen dhe riparimin e biçikletës (çekiç, çelësa, pinca, kaçavida, leva etj.).

- Procedura e grasatimit dhe vajisjes së pjesëve të lëvizshme të biçikletës janë:
  - përzgjedhja e grasos dhe e vajit të duhur;
  - çmontimi i kapakëve të kushinetave me sfera (te akset e rrotave, aksi i mesit, akset e pedaleve etj.);
  - grasatimi i kushinetave me sfera;
  - montimi i kapakëve të kushinetave me sfera;
  - vajisja e zinxhirit të biçikletës;
  - grasatimi ose vajisja e pjesëve të tjera të lëvizshme të biçikletës;
  - prova e funksionimit të pjesëve të biçikletës, të vajisura dhe të grasatuara.
- Procedura e riparimit të gomës së përparme të shpuar, të biçikletës është:
  - çmontimi i rrotës së përparme nga piruni i timonit të biçikletës;
  - çmontimi i ventilit të kamerdares nga disku i rrotës;
  - heqja e kopertonit dhe kamerdares nga disku;
  - kontrolli i gjendjes së kopertonit;
  - fryrja e kamerdares,



**Riparimi i gomës**

- përcaktimi dhe shënimi i vendit të shpuar;
  - shfryrja e kamerdares, pastrimi dhe zmerilimi i sipërfaqes së vendit të shpuar të kamerdares.
  - pastrimi dhe zmerilimi i sipërfaqes së pullës prej gome;
  - lyerja me ngjitës (mastiç) i sipërfaqeve që do të ngjiten;
  - ngjitja e pullës në vendin e shpuar të kamerdares;
  - fryrja jo e plotë e kamerdares;
  - montimi i ventilit të kamerdares në diskut e rrotës;
  - vendosja në diskut e kopertonit dhe kamerdares së riparuar;
  - fryrja e gomës së përparme dhe kontrolli i rregullsisë së montimit;
  - montimi i rrotës së përparme në pirunin e timonit të biçikletës;
  - prova e funksionimit të rrotës së riparuar.
- Procedura e zëvendësimit të zinxhirit të biçikletës është:
    - lirimi i bulonave të aksit të rrotës së prapme të biçikletës (kur është pa kompanjölë);
    - shtyrja e rrotës së përparme, lirimi dhe nxjerrja e zinxhirit nga ingranimi me pinjonin;
    - heqja e rrotës së prapme;
    - heqja e zinxhirit të konsumuar nga korona;
    - vendosja dhe ingranimi në koronë të zinxhirit të ri;
    - vendosja dhe rrotës së prapme dhe ingranimi i zinxhirit me pinjonin.
    - regjistrimi i pozicionit të rrotës së prapme dhe shtrëngimi i bulonave të aksit të saj;
    - prova e funksionimit të zinxhirit të zëvendësuar.
    - vajisja e zinxhirit të zëvendësuar.



**Zëvendësimi i zinxhirit të biçikletës**

- Procedura e zëvendësimit të kabullit të frenit të biçikletës është:
  - heqja e pjesës së kabullit të këputur nga doreza e frenit;
  - lirimi i vidës dhe heqja e pjesës së kabullit të këputur nga nofullat e frenave;
  - futja e kokës së kabullit të ri në folenë e dorezës së frenit;
  - futja e kabullit të ri në guajnin e frenit;
  - shtrëngimi i kabullit të ri në vidën e nofullit të frenit;
  - regjistrimi i shtrëngimit dhe i hapësirës së frenimit;
  - prova e frenimit me kabullin e zëvendësuar.
- Procedurat e zëvendësimit të pjesëve të ndryshme të biçikletës (shalës, timonit, fenerit, ziles, parafango, pedaleve etj.) janë:
  - lirimi i vidave shtrënguese të tubit mbajtës të shalës dhe heqja e shalës së dëmtuar;
  - vendosja në fole e shalës zëvendësuese;
  - regjistrimi i lartësisë dhe pozicionit të duhur të shalës zëvendësuese;
  - lirimi i vidave shtrënguese të tubit mbajtës të timonit të dëmtuar dhe heqja e tij;
  - vendosja në fole e timonit zëvendësues;
  - regjistrimi i lartësisë dhe pozicionit të duhur të timonit zëvendësues;
  - lirimi i vidave shtrënguese të flanaxës mbajtëse të fenerit të dëmtuar dhe heqja e tij;
  - shkëputja e lidhjeve elektrike të fenerit;
  - vendosja, regjistrimi dhe shtrëngimi i flanaxës së fenerit zëvendësues;
  - rivendosja e lidhjeve elektrike të fenerit zëvendësues;
  - lirimi i vidave shtrënguese dhe heqja e ziles së dëmtuar të biçikletës;
  - vendosja dhe shtrëngimi i ziles zëvendësuese të biçikletës;
  - lirimi i vidave shtrënguese dhe heqja e parafangos së dëmtuar të biçikletës;
  - vendosja dhe shtrëngimi i parafangos zëvendësuese të biçikletës;
  - lirimi i aksit dhe heqja e pedalit të dëmtuar të biçikletës;
  - vendosja dhe shtrëngimi i aksit të pedalit zëvendësues të biçikletës;

- heqja nga aksi i krahut të pedalit të dëmtuar të biçikletës;
  - vendosja dhe shtrëngimi në aks i krahut të pedalit zëvendësues të biçikletës;
  - çmontimi i pjesëve të tjera të dëmtuara të biçikletës;
  - montimi i pjesëve të tjera zëvendësuese të dëmtuara të biçikletës.
- Kujdesi për veglat e punës:
    - rregullat dhe veprimet për mirëmbajtjen e veglave, instrumenteve dhe pajisjeve për punimet e riparimit dhe të mirëmbajtjes së biçikletës;
    - pastrimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës, pas kryerjes së punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së biçikletës;
    - sistemimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
    - pastrimi i vendit të punës pas kryerjes së punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së biçikletës;
    - kujdesi për sistemimin e materialeve të punës për punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes së biçikletës.
- Sigurimi teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë riparimit dhe mirëmbajtjes së biçikletës përfshin:
    - rregullat dhe veprimet për mbrojtjen nga dëmtimet fizike (prerjet, thyerjet, goditjet, traumat, dëmtimet e syve etj.) gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së biçikletës;
    - rregullat dhe veprimet për mos-dëmtimin e mjedisit, mjeteve dhe materialeve të punës gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së biçikletës;
    - rregullat dhe veprimet për mbrojtjen e mjedisit rrethues gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së biçikletës;
    - veprimet për dhënien e ndihmës së parë për personat e dëmtuar gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së biçikletës.

***Në lidhje me RM3: Nxënësi kryen zëvendësime të pjesëve të bravave të dyerve.***

Rezultati Mësimor Nr.3 është me karakter praktik dhe synon aftësimin e nxënësve për të kryer çmontimin dhe montimin, si dhe zëvendësimin e pjesëve të bravave të dyerve të banesave, me përdorimin e

veglave, instrumenteve dhe materialeve përkatëse. Zbatimi i rregullave të sigurisë duhet të jetë përparësi gjatë realizimit të kësaj RM-je.

Në këtë RM përfshihen këto përmbytje kryesore dhe plotësuese:

- Përcaktimi i parregullsive të bravës së derës është:
  - kontrolli me sy për përcaktimin e parregullsive mekanike të bravës së derës;
  - kontrolli i funksionimit të pjesëve të veçanta të bravës së derës;
  - kontrolli i funksionimit të hapjes dhe mbylljes së derës.

Përzgjedhja e veglave të punës për zëvendësimin e bravës së derës (çekiç, darë, pinca, kaçavida, dalta etj.).

Përzgjedhja e pjesëve të bravës për zëvendësim (vida, gjuhëza brave, doreza brave, fishekë brave, kapakë brave etj.).

- Procedura e çmontimit të dorezave të bravës së derës është:
  - lirimi i vidave të kapakëve të dorezave të bravës;
  - heqja e kapakëve të dorezave të bravës;
  - heqja e dorezave të bravës.



- Procedura e çmontimit të kapakëve të bravës është:
  - lirimi i vidave të kapakëve të bravës;
  - heqja e kapakëve të bravës.

- Procedura e çmontimit të fishekut të bravës është:

### Zëvendësimi i bravës së derës

- lirimi i vidës mbajtëse të fishekut të bravës;
- futja e çelësit në fishekun e bravës dhe rrotullimi i tij deri në pozicionin e duhur për heqjen e fishekut;
- heqja e fishekut të bravës.
  
- Procedura e çmontimit të trupit të bravës është:
  - lirimi i vidave të trupit të bravës.
  - heqja e bravës nga foleja e derës.
  
- Procedura e montimit të trupit të bravës së re është:
  - vendosja e bravës së re në folenë e derës;
  - shtrëngimi i vidave të trupit të bravës.
  
- Procedura e montimit të fishekut të ri të bravës është:
  - futja e çelësit në fishekun e bravës dhe rrotullimi i tij deri në pozicionin e duhur për futjen e fishekut;
  - futja e fishekut në folenë e bravës, në thellësinë e duhur;
  - vendosja dhe shtrëngimi i vidës mbajtëse të fishekut të bravës.
  
- Procedura e montimit të kapakëve të bravës së derës është:
  - vendosja e kapakëve të bravës në pozicionet e duhura;
  - vendosja dhe shtrëngimi i vidave të kapakëve të bravës.
  
- Procedura e montimit të dorezave të bravës së derës është:
  - vendosja e dorezave të bravës në folenë përkatëse;
  - vendosja e kapakëve të dorezës së bravës;
  - vendosja dhe shtrëngimi i vidave të kapakëve të dorezës së bravës.
  
- Prova e funksionimit të bravës së derës me pjesë të zëvendësuara është:
  - prova e funksionimit të gjuhëzës së bravës me komandim me çelës;
  - prova e funksionimit të gjuhëzës së bravës me komandim me dorezë;
  - prova e funksionimit të mbylljes dhe hapjes së derës, me dorezë dhe me çelës;
  - vajtësja e pjesëve të bravës së derës.

- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës janë:
  - rregullat dhe veprimet për mirëmbajtjen e veglave, instrumenteve dhe pajisjeve për punimet e riparimit dhe të mirëmbajtjes së bravës së derës;
  - pastrimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës, pas kryerjes së punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së bravës së derës;
  - sistemimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
  - pastrimi i vendit të punës pas kryerjes së punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së bravës së derës;
  - kujdesi për sistemimin e materialeve të punës për punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes së bravës së derës.
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të pjesëve të bravës së derës janë:
  - veprimet për mbrojtjen nga dëmtimet fizike (prerjet, thyerjet, goditjet, traumat, dëmtimet e syve etj.) gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së bravës së derës;
  - veprimet për mos-dëmtimin e mjedisit, mjeteve dhe materialeve të punës gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së bravës së derës;
  - veprimet për mbrojtjen e mjedisit rrethues gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së bravës së derës;
  - veprimet për dhënien e ndihmës së parë për personat e dëmtuar gjatë punimeve të riparimit dhe të mirëmbajtjes së bravës së derës.

**Në lidhje me RM4: Nxënësi kryen mirëmbajtje të thjeshta në automjetet e lehta.**

Rezultati Mësimor Nr.4 është me karakter praktik dhe synon aftësimin e nxënësve për të kryer punime të thjeshta të mirëmbajtjes në automjetet e lehta (autoveturat), me përdorimin e veglave, instrumenteve dhe materialeve përkatëse. Zbatimi i rregullave të sigurisë duhet të jetë përparësi gjatë realizimit të kësaj RM-je.

Në këtë RM përfshihen këto përmbajtje kryesore dhe plotësuese:

- Parkimi i automjetit në një vend të sigurt, pa rreziqe, si dhe marrja e masave që automjeti të jetë i frenuar.
- Analiza e katalogut të automjetit (leximi dhe interpretimi i skemave dhe i simboleve që përdoren për paraqitjen e sistemeve dhe mekanizmave të automjetit).
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për të kryer mirëmbajtje të thjeshta të automjetit të lehtë (çekiç, çelësa, pinca, kaçavida, pajisje ngritëse, lecka pastrimi, rrotë rezervë, vaj makinash, ujë, ujë me solucion antifriz etj.).
- Procedura e plotësimit me vaj të motorit të automjetit është:
  - ngritja e mbulesës së motorit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së saj;
  - nxjerrja e shufrës së nivelit të vajit, pastrimi i saj dhe futja përsëri në folenë e saj;
  - kontrolli i nivelit të vajit;
  - heqja e kapakut të vajit;
  - hedhja e sasisë së duhur të vajit (nëse është e nevojshme);
  - rikontrolli i nivelit të vajit dhe rimbushja deri në arritjen e nivelit të duhur;
  - vendosja në fole e shufrës së nivelit të vajit;
  - vendosja dhe shtrëngimi i kapakut të vajit;
  - ulja e mbulesës së motorit.
- Procedura e plotësimit me ujë të rezervuarit të ujit të sistemit të ftohjes së motorit është:
  - ngritja e mbulesës së motorit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së saj;
  - kontrolli dhe përcaktimi i nivelit të ujit në rezervuarin e sistemit të ftohjes së motorit;
  - heqja e kapakut të rezervuarit të ujit të sistemit të ftohjes (kur motori është i ftohtë);
  - hedhja e sasisë së duhur të ujit me antifrizë në rezervuarin e ujit të sistemit të ftohjes (nëse është e nevojshme);
  - vendosja dhe shtrëngimi i kapakut të rezervuarit të ujit të sistemit të ftohjes;
  - ulja e mbulesës së motorit.



- Procedura e zëvendësimit të fshirëseve të xhamave të automjetit të lehtë është:

- kontrolli i funksionimit të fshirëseve të xhamave;
- ngritja e krahut të fshirësit të xhamit;
- procedura e heqjes së fshirësit të xhamit nga krahu përkatës;
- procedura e vendosjes së fshirësit të ri të xhamit në krahu përkatës;
- ulja e krahut të fshirësit të xhamit;
- kontrolli i funksionimit të fshirësit të zëvendësuar të xhamit.



**Zëvendësimi i fshirësit të xhamit**

- Procedura e zëvendësimit të filtrit të ajrit të motorit të automjetit të lehtë është:
- ngritja e mbulesës së motorit dhe



**Zëvendësimi i rrotës**

- sigurimi i qëndrueshmërisë së saj;
  - çmontimi dhe largimi i kapakut të folesë së filtrit të ajrit të motorit;
  - heqja e filtrit të ajrit nga foleja e tij;
  - pastrimi i folesë nga papastërtitë;
  - vendosja në fole e filtrit të ri të ajrit;
  - vendosja dhe montimi i kapakut të folesë së filtrit të ajrit të motorit;
  - ulja e mbulesës së motorit.
- Procedura e vendosjes së rrotës rezervë të automjetit të lehtë është:
    - vendosja e automjetit të lehtë në pozicion të sigurt dhe të frenuar;
    - lirimi i pjesshëm i bulonave (dadiçekëve) të rrotës së dëmtuar që do të zëvendësohet me rrotën rezervë;
    - vendosja e krikut në pozicionin e duhur për ngritjen e automjetit;
    - ngritja e automjetit në krik;
    - lirimi i plotë dhe heqja e bulonave (dadiçekëve) të rrotës së dëmtuar që do të zëvendësohet me rrotën rezervë;
    - heqja nga aksi e rrotës së dëmtuar që do të zëvendësohet me rrotën rezervë;
    - çmontimi i rrotës rezervë nga foleja e saj në automjet;
    - vendosja e rrotës rezervë në pozicionin e duhur, në aksin e automjetit të lehtë;
    - vendosja dhe shtrëngimi i pjesshëm i bulonave (dadiçekëve) të rrotës rezervë;
    - lirimi i krikut, ulja e automjetit dhe heqja e krikut;
    - shtrëngimi i plotë i bulonave (dadiçekëve) të rrotës rezervë;
    - kontrolli përfundimtar i vendosjes së rrotës rezervë të automjetit të lehtë.
  - Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës janë:
    - rregullat dhe veprimet për mirëmbajtjen e veglave, instrumenteve dhe pajisjeve për punimet e mirëmbajtjes në automjetet e lehta;
    - pastrimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës, pas kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes në automjetet e lehta;
    - sistemimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;

- pastrimi i vendit të punës pas kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes në automjetet e lehta;
- sistemimi i materialeve të punës për punime të mirëmbajtjes në automjetet e lehta.
  
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë mirëmbajtjes së thjeshtë të automjeteve të lehta janë:
  - veprimet për mbrojtjen nga dëmtimet fizike (prerjet, thyerjet, goditjet, traumat, dëmtimet e syve etj.) gjatë punimeve të mirëmbajtjes në automjetet e lehta;
  - veprimet për mos-dëmtimin e mjedisit, mjeteve dhe materialeve të punës gjatë punimeve të mirëmbajtjes në automjetet e lehta;
  - veprimet për mbrojtjen nga zjarri gjatë punimeve të mirëmbajtjes në automjetet e lehta;
  - veprimet për mbrojtjen e mjedisit rrethues gjatë punimeve të mirëmbajtjes në automjetet e lehta;
  - veprimet për dhënien e ndihmës së parë për personat e dëmtuar gjatë punimeve të mirëmbajtjes në automjetet e lehta.

***Në lidhje me RM5: Nxënësi kryen punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit në pajisje të ndryshme mekanike me përdorim shtëpiak.***

Rezultati Mësimor Nr.5 është me karakter praktik dhe synon aftësimin e nxënësve për të kryer punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit në pajisje të ndryshme mekanike shtëpiake (karrocet e fëmijëve, krevatet portative metalike, menteshat e kapakëve të rafteve, tavolinat metalike, karriget metalike etj.), me përdorimin e veglave, instrumenteve dhe materialeve përkatëse. Zbatimi i rregullave të sigurisë duhet të jetë përparësi gjatë realizimit të kësaj RM-je.

Në këtë RM përfshihen këto përmbajtje kryesore dhe plotësuese:

- Kontrolli dhe përcaktimi i parregullsive të karrocet e fëmijëve, krevatet portative metalike, menteshat e kapakëve të rafteve, tavolinat metalike, karriget metalike etj, janë:
  - leximi dhe interpretimi i katalogëve dhe manualeve të objekteve

- dhe pajisjeve të ndryshme mekanike me përdorim shtëpiak;
- kontrolli me sy për përcaktimin e parregullsive mekanike të objekteve dhe pajisjeve të ndryshme mekanike me përdorim shtëpiak;
  - kontrolli i funksionimit të objekteve dhe pajisjeve të ndryshme mekanike me përdorim shtëpiak, si dhe i pjesëve të veçanta të tyre;
  - matjet dhe kontrollet me instrumente për përcaktimin e parregullsive të objektet dhe pajisjet e ndryshme mekanike me përdorim shtëpiak.

Përzgjedhja e veglave të punës për punime të thjeshta mekanike tek objektet dhe pajisjet mekanike shtëpiake (çekiçë, çelësa, pinca, kaçavida, darë, hegzagonë, makina shpuese elektrike, sharra metalike, dalta, lima, letër zmerile etj.).

- Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të karrocës së fëmijëve janë:
  - procedura e rimontimit të pjesëve të liruara ose të çmontuara të karrocës;
  - procedura e shtrëngimit të lidhjeve me fileto, të liruara ose të shfletuara;
  - procedura e drejtimit të pjesëve (tubave) të shtrembëruara të trupit të karrocës;
  - procedura e zëvendësimit të pjesëve të këputura të trupit të karrocës;
  - procedura e



**Karrocë fëmijësh**

- zëvendësimin të rrotave të dëmtuara të karrocës;
- procedura e grastimit dhe vajtjes së pjesëve të lëvizshme të karrocës.
- Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimin te krevatet portative metalike janë:
  - procedura e rimontimit të pjesëve të liruara ose të çmontuara të krevatit portativ metalik;
  - procedura e shtrëngimit të lidhjeve me fileto, të liruara ose të shfletuara;
  - procedura e drejtimit të pjesëve (profileve) të shtrembëruara të trupit të krevatit portativ metalik;
  - procedura e zëvendësimin të pjesëve të këputura të trupit të krevatit portativ metalik.
- Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimin te menteshat e kapakëve të rafteve janë:
  - procedura e shtrëngimit të vidave të liruara për mbërthimin e menteshave me kapakët dhe trupin e raftit;
  - procedura e regjistrimit të menteshave të kapakëve të rafteve;
  - procedura e zëvendësimin të menteshave të kapakëve të rafteve;
  - kontrolli i funksionimit të menteshës së regjistruar ose të zëvendësuar.
- Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimin te tavolinat metalike janë:
  - procedura e rimontimit të pjesëve të liruara ose të çmontuara të tavolinës metalike;
  - procedura e shtrëngimit të lidhjeve me fileto, të liruara ose të shfiletuara;
  - procedura e drejtimit të pjesëve (këmbëve) të shtrembëruara të tavolinës metalike;
  - procedura e zëvendësimin të pjesëve të këputura të tavolinës metalike.
- Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimin te karriget metalike janë:

- procedura e rimontimit të pjesëve të liruara ose të çmontuara të karriges metalike;
- procedura e shtrëngimit të lidhjeve me fileto, të liruara ose të shfiletuara;
- procedura e drejtimit të pjesëve (këmbëve) të shtrembëruara të karriges metalike;
- procedura e zëvendësimit të pjesëve të këputura të karriges metalike.
  
- Punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të pajisjet e tjera metalike me përdorim shtëpiak janë:
  - procedura e rimontimit të pjesëve të liruara ose të çmontuara të pajisjeve të tjera metalike;
  - procedura e shtrëngimit të lidhjeve me fileto, të liruara ose të shfiletuara;
  - procedura e drejtimit të pjesëve të shtrembëruara të pajisjeve të tjera metalike;
  - procedura e zëvendësimit të pjesëve të këputura të pajisjeve të tjera metalike.
  
- Kujdesi për veglat e punës, rregullat dhe veprimet për mirëmbajtjen e veglave, instrumenteve dhe pajisjeve për punimet e thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit në pajisjet mekanike shtëpiake janë:
  - pastrimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës, pas kryerjes së punimeve të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit në pajisjet mekanike shtëpiake;
  - sistemimi i veglave, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
  - pastrimi i vendit të punës pas kryerjes së punimeve të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit në pajisjet mekanike shtëpiake;
  - kujdesi për sistemimin e materialeve të punës për punime thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit në pajisjet mekanike shtëpiake.
  
- Rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të thjeshta të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjet metalike me përdorim shtëpiak janë:
  - veprimet për mbrojtjen nga dëmtimet fizike (prerjet, thyerjet, goditjet, traumat, dëmtimet e syve etj.) gjatë punimeve të thjeshta

të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve metalike me përdorim shtëpiak;

- veprimet për mos-dëmtimin e mjedisit, mjeteve dhe materialeve të punës gjatë punimeve të thjeshta të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjet metalike me përdorim shtëpiak;
- veprimet për mbrojtjen e mjedisit rrethues gjatë punimeve të thjeshta të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve metalike me përdorim shtëpiak;
- veprimet për dhënien e ndihmës së parë për personat e dëmtuar gjatë punimeve të thjeshta të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve metalike me përdorim shtëpiak.

### **3.2. Udhëzime për metodologjinë dhe kushtet e zbatimit të Modulit**

#### ***Për aspektet teorike:***

- Aspektet teorike të modulit trajtohen kryesisht te RM1.
- Ky RM rekomandohet të trajtohet në klasë mësimore të pajisur me mjete pamore ilustruese (pankarta, projektor elektronik, makete etj.).
- Disa objekte mekanike të klasës (bravat e dyerve, tavolinat e karriget metalike, menteshat e ndryshme etj.) mund të shërbejnë si objekte ilustruese për aspektet teorike të RM1. Objekte mekanike si biçikleta, mund të sillen në klasë për konkretizim, ndërsa një autoveturë në oborrin e shkollës, mund të shërbejë gjithashtu për konkretizim.
- Gjatë trajtimit të kësaj RM-je nxënësve mund t'u jepen detyra shtëpie që i referohen aspekteve teorike, mbledhjes së informacionit dhe vëzhgimit të objekteve mekanike shtëpiake, biçikletave, autoveturave.
- Nxënësve duhet t'u kërkohet që të punojnë në grupe dhe të bëjnë prezantime në klasë të detyrave të kryera dhe që kanë lidhje me aspektet teorike që trajtohen në RM1.



***Për aspektet praktike:***

- Vendi kryesor ku duhet të trajtohen aspektet praktike të modulit (RM2 – RM5) duhet të jenë mjediset e shkollës (klasë, laborator, oborr).
- Nxënësve duhet t'u kërkohet që të kryejnë punime të riparimit dhe të mirëmbajtjes mekanike edhe në mjediset e banesave të tyre, në automjetet e prindërve të tyre, si dhe të referojnë e diskutojnë në klasë në lidhje me to.
- Rekomandohen edhe vizita të nxënësve në biznese ku kryhen punime të riparimit e mirëmbajtjes mekanike, pika servisi biçikletash dhe automjeteve, reparte mekanike etj.
- Mësuesit duhet që paraprakisht, të demonstrojnë vetë procedurat e punimeve të mirëmbajtjes dhe të riparimit mekanik, të cilat i përmbajnë RM-të praktike. Për punimet te biçikletat dhe tek autoveturat, këto të fundit mund të sillen në oborrin e shkollës dhe të kryhen punime të thjeshta mekanike te këto objekte. Pas demonstrimeve të mësuesit, nxënësit duhet të praktikohen nën mbikëqyrjen e tij dhe pastaj në mënyrë të pavarur, aty ku nuk ka rreziqe për sigurinë e jetës dhe dëmtimin e objekteve, mjeteve dhe mjedisit të punës.
- Duhet që të ***zbatohen me rreptësi rregullat e sigurisë*** gjatë kryerjes së veprimtarive praktike të nxënësve, si dhe të mbikëqyren nga mësuesit aty ku siguria është parësore.
- Në rastet kur shkolla nuk i disponon mjetet dhe materialet e duhura për realizimin e RM-ve praktike, nxënësit mund të sjellin nga shtëpia vegla dhe materiale pune, si dhe objekte mekanike shtëpiake të cilat mund të kryhen punimet e parashikuara në RM-në përkatëse.
- Rekomandohen të përdoren metoda e punës me grupe të nxënësve, si dhe metoda e simulimit të parregullsisve të objektet mekanike që do të riparohen e mirëmbahen.

***Për vlerësimin e nxënësve:***

- Vlerësimi i nxënësve për aspektet teorike duhet të bazohet kryesisht te pyetjet-përgjigjet me gojë. Edhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë duhet të ketë peshën e duhur në rezultatet e vlerësimit të nxënësve



për këto aspekte.

- Vlerësimi i nxënësve për aspektet praktike duhet të bazohet kryesisht te Listat e kontrollit, të cilat duhet të përmbajnë kritere që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve praktike, përdorimin e mjeteve të punës dhe zbatimin e rregullave të sigurisë. Nxënësve mund t'u vlerësohet procedura e punës, por në disa raste (kur veprimtaritë kryhen në shtëpi) mund të vlerësohet vetëm produkti i punës.